



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 113

Prishtinë, më 13.5.2013, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina, Nijazi Idrizi, Daut Haradinaj.

Munguan : Liburn Aliu, Rasim Demiri, Boban Todorović.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi dhe Flaka Broqi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 29.4.2013 dhe 7.5.2013,
3. Shqyrtimi i vërejtjeve nga dëgjimi publik,
4. Vizita në Shqipëri,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime dhe u shtua për “Të ndryshme” shqyrtimi i konfirmimit për leximin e dytë të “Blegtorisë” dhe sugjerimi për takimin me Komisionin për Legjislacion.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29.4.2013 dhe 7.5.2013

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 29.4.2013 dhe 7.5.2013.

3. Shqyrtimi i vërejtjeve nga dëgjimi publik për Projektligjin e Planifikimit Hapësinor dhe Trajtimin e ndertimeve pa leje

Kryetari Nait Hasani njoftoi komisionin se Liburn Aliu mungon me arsye, ndaj në mungesë të informimit nga ai Komisioni do të presë dy javë për vërejtjet me shkrim aq sa është kërkuar nga komisioni më 7 maj nga pjesëmarrësit në debat publik (sipas ndërhyrjes së **Afërdita Berishës**), për të vazhduar pastaj punën në grupin punues, njëherit komisioni do të kërkojë afat shtesë nga kryesia për këto dy projektligje, ndërkaq **Salih Morina** rikujtoi premtimin e dhënë nga USAID/BEEP që para se të shqyrtohen mirë këto dy projekte (planifikimi hapësinor dhe ndërtimet pa leje), komisioni të vizitojë një vend në rajon rreth përvojave të tyre në këtë fushë, ndaj mirë do të ishte të pyetet ky projekt a qëndrojnë pranë fjalëve që kanë dhënë për mbështetje të vizitës. **Kryetari** gjithashtu rikujtoi se MMPH në fillim ka premtuar Stambollin ose Kroacinë. Ai përmbylli këtë pikë me konstatimin se Komisioni do të takohet në grup punues pasi të kalojë afati për dorëzimin e vërejtjeve nga pjesëmarrësit e debatit publik.

4. Vizita në Shqipëri

Kryetari Nait Hasani njoftoi komisionin se është kërkuar nga Sekretari i Kuvendit që Kryesisë së Kuvendit të sugjeroi shtyrjen e dy pikave të mbledhjes plenare për 16 maj të cilat kanë të bëjnë me këtë Komision për shkak të vizitës së Komisionit në Shqipëri, por kërkojë që anëtarët e komisionit për mbledhjen e radhës plenare të përgatiten rreth debatit plenar për pyjet e Kosovës dhe të marrin pjesë në këtë mbledhje. **Salih Morina** kërkojë që materiali për pyje të ju dërgohet anëtarëve të komisionit nga stafi i komisionit deri atëherë, ndërsa **Daut Haradinaj** gjithashtu kërkojë që materiali të përgatitet për vizitën në Shqipëri me draftin e propozuar. Pasi që Komisioni nuk kishte vërejtje në agjendën e propozuar, **parimisht Komisioni u dakordua që nisa për në Shqipëri të bëhet të enjten më 16 maj në orën 14,00.**

5. Të ndryshme

Kryetari Nait Hasani me pajtimin e komisionit konfirmuan si vijon :

- **Projektligji për Blegtorinë** përcjellët për leximin e dytë pasi që Komisionet e përhershme kanë përfunduar procedimin pa ndonjë vërejtje konkrete,
- Rreth Projektligjit për ndërtesat në bashkëpronësi komisioni arsyetoi sërish qëndrimin për mbledhje të përbashkët me Komisionin për legjislacion, ngase kemi të bëjmë me dilema të cilat duhet të shqyrtohen bashkërisht,
- Kryetari njoftoi komisionin për takimin me datën 22 maj rreth Masakrës së Dubravës në SWIS DAIMOND.

Mbledhja përfundoi në orën 11,40.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani

